



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



878/19
17.12.19

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Shefkinaze Vllasaliu 	10.12.2019	17.12.2019	878-19
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.12.2019, Tenderuesi : “Beni Dona Plast” sh.p.k., Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 878/19, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – anulimi i aktivitetit të prokurimit të publikuar me datë 25.11.2019, lidhur me aktivitetin e prokurimit:
Titulli: FURNIZIM ME USHQIM PËR PK-ËN – RI-TENDER
me nr. të prokurimit: 214-19-5204-1-1-1 dhe Numri i brendshëm: 214/19/043/111
i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 1.140,016.40 €,

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Dispozitat e shkelura të LPP-së, sipas tenderuesit ankues Beni Dona Plast SH.P.K., Prishtinë, nga ana e Autoriteti Kontraktues/POLICIA E KOSOVËS janë si në vijim:

Pas shikimit në dokumente zyrtare si dhe pas trajtimit të Raportit të vlerësimit të tenderëve të datës 30/08/2019, krahasimit dhe vlerësimit të dokumenteve të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me ushqim për PK-në — ri- tender”) me Nr. i AP: 214-19-5204-1-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 214/19/043/111, Ne në cilësinë e OE-së të interesuar konsiderojmë se shpallja e Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues — Anulim i aktivitetit të prokurimit i publikuar në ueb faqen e platformës elektronike të KRPP-së me datë 30/08/2019; nga Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës 10000 Prishtinë: është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së si dhe të gjitha aktet tjera nën ligjore që kanë të bëjnë me prokurimin publik në Republikën e Kosovës. Në këtë mënyrë e ka dëmtuar interesin material-

financiar të kompanisë në fitimin e kontratës publike në mënyrë të rregullt dhe ligjore.

Shkeljet e dispozitave ligjore nga AK — Policia e Kosovë Rr "Luan Haradinaj", nr.99 ndërtesa e re e administratës, kati H, zyra nr. 32, Prishtinë Republika e Kosovës, pas pranimit të Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues — Anulim i aktivitetit të prokurimit i publikuar në ueb faqen e platformës elektronike të KRPP-së me datë 30/08/2019;

- *Është shkelur neni 1 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (qëllimi, shfrytëzimi më efikas, më transparent dhe më i drejtë i fondeve publike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92;*
- *Është shkelur neni 2 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Fushëveprimi) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237 ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,*
- *Është shkelur neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (ekonomiciteti dhe efikasiteti i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,*
- *Është shkelur neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).*
- *Është shkelur neni 40 i RRUOPP-së (Krijimi i Komisioneve Vlerësuese të tenderëve). —paragrafi 40.13*
- *Është shkelur neni 41 i RRUOPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).*
- *Është shkelur neni 62 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Përfundimi I Aktivitetit të Prokurimit) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L- 068 dhe ligjin Nr.05/L-92,*
- *Është shkelur neni 44.5 i RRUOPP (Ndërprerja e procedurave të prokurimit),*
- *Është shkelur neni 105 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Kompetencat e OSHP-së) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L- 068 dhe ligjin Nr.05/L-92, paragrafi 2.10 i këtij neni*

Në kërkesën të cilën iu kemi dërguar me dt.02.09.2019, me këtë përmbajtje ju na keni kthye një përgjigje në të cilin nuk na keni dhënë ndonjë përgjigje të mjaftueshme.

Lënda: SHKRESE për sqarime të Anulimit të Aktivitetit të Prokurimit

Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e Prokurimit me titull: "Furnizimi me ushqim për PK-ën Ri-Tender", me nr. Prokurimi: 214-19-5204-1-I-1, e kemi pranuar. Sipas këtij njoftimi Autoriteti i juaj Kontraktues ka marr vendim që ky aktivitet të anulohet.

Është e vërtetë se edhe ligji i Prokurimit Publik nr.04/L-042 i ndryshuar dhe i plotësuar, në nenin 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit e parasheh se një anulim i tillë mund të behët, po ashtu edhe RRUPP - neni 44 - Ndërprerja e Aktivitetit të Prokurimit, po ashtu sikurse edhe ligji e trajton çështjen e anulimit — ndërprerjes së Aktivitetit të Prokurimit.

Ju në njoftimin e Publikuar përmes Platformës elektronike të E-Prokurimit me dt.30.08.2019 nuk keni dhënë asnjë sqarim të vetëm për arsyen e marrjes së një vendimi të tillë: - Anulim i aktivitetit të Prokurimit.

- Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit i ligjit nr.04/L-042 paragrafi 1.1 e parasheh këtë çështje por ju jeni të obliguar që të jepni një sqarim të detajuar për arsyen e anulimit të Aktivitetit të lartë përmendura të Prokurimit.
- RRUPP - neni 44 Ndërprerja e Aktivitetit të Prokurimit, paragrafi 44.5 Procedura e prokurimit pas

marrjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

- (i) asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar,
- (ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
- (iii) numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE - është më pak se 3;
- (iv) nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- (v) numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
- (vi) nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- (vii) asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
- (viii) nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
- (viii) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
- (ix) nëse AK ka shkaktuar një gabim teknik në platformë elektronike gjatë udhëheqjes së procedurës dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit nga KRPP; ose
- (x) nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

44.6 Procedura e prokurimit pas marrjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: (i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Luten që mundësisht të na jepni një sqarim për arsyen e anulimit të Aktivitetit të Prokurimit të lartë cekur në mënyrë që ne në afatin e paraparë Ligjor të ushtrojmë Kërkesë për Rishqyrtim nëse i vlerësojmë së Anulimi i Aktivitetit të Prokurimit është në kundërshtim me Paragrafët e ligjit LPP dhe RRUP të cilët i cekur me lartë.

Ju faleminderit për mirëkuptim!

Ragip Mustafa, drejtor i SH.P.K "Beni Dona Plast"

Nr. Personal :1000661151

Vendbanimi, Prishtinë Rr, ""IMZOT NIK PRELAJ ,ULPIANE

Përgjigja juaj dt.02.09.2019:

Te nderuar,

Ju njoftoj se aktiviteti i prokurimit është anuluar konform LPP-ës, përkatësisht nenit 62 të LPP ku thuhet "një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit".

Gabimet e shumta në specifikat teknike kanë qar në anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, pra vazhdimi tutje i këtij aktiviteti të prokurimit ka qen i pa mundur me lëshimin që kane qen në specifikat teknike.

Për çdo informatë me te hollësishëm munde te keni qasje ne dokumente.

Me respekt !

Enver Hyseni

Zyrtar i lart i Prokurimit

Policia e Kosovës,

Rr."Luan Haradinaj"-nr.99 Ndërtesa e re e Administratës kati i II-të, zyra nr.33 Prishtinë Tel: 038/5080 1520

Në Kërkesën tonë të cilën e kemi bërë për sqarime shitesë të tenderit me dt. 26/07/2019, në të cilën kanë qenë të përfshira një numër i madh i paqartësive të cilat ne i kemi identifikuar ju na keni kthye një përgjigje se çdo gjë është në rregull ndërsa tash po del se të gjitha 14 Pakot të cilat ju i keni radhitur në dosjen e tenderit nga diçka po ju mungon dhe Specifikimet teknike për këto pako nuk janë në rregull sipas juve.

Për: Policia e Kosovës

10 000, Prishtine, Republika e Kosovës

Zyra e Prokurimit

Nga: "Beni Dona Plast" Shpk

10 000, rr.Imzot NikPrelaj

Prishtinë, Republika e Kosovës

Dt. 26.07.2019

Lënda: SHKRESE për sqarime te tenderit

Kërkojmë sqarime shitesë për këto pika për tenderin e shpallur nga ju me titull: "Furnizimi me ushqim për PK-ën Ri-Tender", me nr. Prokurimi: 214-19-5204-1-1-1.

Për shkak të rëndësisë së këtij aktiviteti të Prokurimi dhe kërkesat që janë parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit kërkojmë që të shtohen edhe disa kriteret të cilat janë shumë me rëndësi dhe pa të cilat jemi të bindur se ky aktivitet i prokurimit nuk do të mund të realizohej në mënyre cilësore dhe ashtu si që duhej po të mos i vendosini edhe këto kërkesa:

A) Kapaciteti ekonomik dhe financiar ~ ne mendojmë se shumën të cilën ju e keni kërkuar nuk duhet të jetë 1,150,000.00euro por duhet të jetë min. 2,200,000.00 euro.

B) Kapaciteti Teknik dhe profesional

Dëshmia a) Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik Neni 27 par.4. — sipas këtij neni mendojmë se do të ishte shumë më mirë dhe ndoshta e domosdoshme që AK —Policia e Kosovës do të duhej të kishte përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë se si grup i OE duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësitë teknike dhe profesionale të referuara në nenet 68 dhe 69 të LPP-së.

Kjo do të thotë se AK mund të përcaktoj një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga njëri anëtar i grupit të operatorëve ekonomik.

Shembull: Qarkullimi minimal i kërkuar në rastin konkret nga AK është 2,200,000.00 euro ish dashur që të përcaktohet në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit se lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të këtij qarkullimi minimal që do të ishte 1,320,000.00euro

Këtë propozim e kemi bërë jo me qëllim të zvogëlimit apo kufizimit të konkurrencës, por me qëllim që të përzgjidhet një operator ekonomik serioz dhe i cili ka një përvojë më të gjatë në lëmin e gastronomisë.

Po ashtu do të ishte dashur që AK — Policia e Kosovës të kërkonte nga OE të interesuar që të dorëzojnë se paku tri (3) referenca për shërbimet e kryera tri vitet e fundit në të cilat do të specifikohet edhe shuma e këtyre

referencave aq sa është Kapaciteti Ekonomik dhe financiar.

Dëshmia b) OE ku cekte të ketë minimum 20 punëtor, ne mendojmë se është numër i vogël i punëtorëve për të kryer këto shërbime dhe furnizime në mënyrë cilësore dhe në kohën e duhur do të nevojiteshin min. 40 punëtorë gjithashtu të jenë edhe në listën e pagave të paraqitur në ATK-ë tri vitet e fundit.

Dëshmia c) Ku thuhet se duhet të ketë staf profesional min. 4 kuzhinier - ne mendojmë se ky numër i kuzhinierëve është shumë i vogël dhe propozojmë që të jetë min. 10 kuzhinier. Këtë e themi nga provoja e kaluar ku kemi pasur rastin që të porositen 8,000.00 e ndoshta edhe deri në 16,000.00 racione ~ pako brenda një kohe shumë të shkurtër (brenda ditës). Kështu që është e pamundur që vetëm 4 kuzhinier të përgatitin një sasi kaq të madhe të pakove - Racioneve. Duke pasur parasysh se në kontratën e kaluar me nr. Prokurimi: PK-214/16/130/111 ~ citojmë "Vendi i dërgesës është në të gjitha stacionet policore në tërë territorin e RKS aty ku AK kërkon dërgesë. OE duhet të ketë në secilin qytet që ka qendra të paraburgimit një pikë furnizuese, për qendrat e ndalimit OE fitues i lejohet nën kontraktimi dhe para nënshkrimit të kontratës duhet ta sjell listën me nënkontraktuesit e zgjedhur, të gjitha pagesat i bëhen fituesit dhe jo nën kontraktorve".

Drejtoria Rajonale e Prishtinës

Qendra e ndalimit në kuadër të DRP Prishtinë

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Lipjan

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Drenas

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Podujevë

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Graçanicë

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Obiliq

Drejtoria Rajonale e Mitrovicës së Jugut

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Jug Mitrovicë

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Vushtrri

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Skenderaj

Drejtoria Rajonale e Pejës

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Pejë

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Istog

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Klinë

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Deçan

Drejtoria Rajonale e Ferizajt

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Ferizaj

Drejtoria Rajonale e Gjilanit

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Gjilan

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Kamenicë

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Viti

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Klokot

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Ranillug

Drejtoria Rajonale e Mitrovicës së Veriut

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Leposaviq

Drejtoria Rajonale e Prizrenit

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Prizren

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Suharekë

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Dragash

Qendra e ndalimit në Stacionin Policor Mamushë

Qendra e ndalimit ne Stacionin Veri

Drejtoria Rajonale e Gjakovë

Qendra e ndalimit ne Stacionin Policor Gjakovë

Qendra e ndalimit ne Stacionin Policor Malishevë

Qendra e ndalimit ne Stacionin Policor Rahovec

Policia Kufitare

Drejtoria Rajonale Veri Lluzhan Drejtoria

Rajonale Lindje Kaçanik PKK Hani i Elezit

PKK Gllloboqicë

Drejtoria Rajonale e Policisë Gjakovë PKK Vermicë

PKK Qafa e Prushit Qafa e

Morinë

Këto vende që i kemi cekur për Qendra të ndalimit ka ndodhur shumë shpesh të na bëhet kërkesa për dërgimin e pakove ose racionet në orët e vona të mbrëmjes sipas operacioneve të cilat i kanë zhvilluar nëpër territore dhe vendbanime të ndryshme të Rep. së Kosovës.

Gjithashtu edhe tek afati kohor për dorëzim që e kemi paraparë 24 orë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e AK – kemi pasur raste të shpeshta që kërkesa për dërgim të pagove apo racioneve ka ndodhur që të bëhet jo brenda 24 orëve ashtu si që ju e keni shënuar ne Dosjen e tenderin dhe në Njoftimin për Kontratë por një kërkesë e tillë të bëhet brenda 30 minuta apo 1 ore. Diçka që edhe me tepër e vështirëson dërgesën në këto situata është se shpesh ndodhe që në momentin e dërgimit përkatësisht shpërndarjes të këtyre pakove – racioneve ka ndodhur shumë shpesh që ta zëmë janë kërkuar 60 pako - racione ku gjatë rrugës të thirret përmes telefonit dhe të thuhet të na dërgoni edhe 20 -30 -40 racione ose pako, që dukshëm e vështirëson mënyrën e furnizimit apo kryerjes së shërbimeve të cilat ju këto raste fare nuk i keni përshkuar me detajishtë ne njoftimin për Kontrate ose ne Dosjen e Tenderit..

Dëshmia d) Sa i përket kërkesës për automjete frigo ku ju keni kërkuar 4 automjete ne mendojmë se ky numër i automjeteve të kërkuara është shumë i vogël duke pasur parasysh rastet të cilat i elaboruam pak ma lartë.

Dëshmia e) Ne mendojmë se OE të interesuar duhet të posedojnë një Restorant me një kapacitet prej min.100 ulëse i cili Restorant nuk mund të jetë me larg se 10km nga Qendra e Prishtinës.

Dëshmia f) Ne mendojmë se OE të interesuar duhet të kenë një Kontrate valide me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë për kontrollin e cilësisë së ushqimit.

Dëshmia g) Sa i përket pakove të cilat janë të specifikuara në dosjen e tenderit në disa prej tyre ekzistojnë të specifikuar nga dy variante (dy mundësi) - Pako 1, Pako 3, Pako 7, Pako 10, Pako 12. Kur është në pyetje pakot të cilat janë të specifikuar nga dy produkte tek të gjitha këto pako – racione që i përmendëm dhe çmimi është i ndryshëm - behet pyetja se si do të bëni porosinë vetëm si pako apo do të bëni ndarjen e produkteve të cilat gjinden brenda pakove .

Pjesa e tortës në disa prej pakove – racioneve është e specifikuar se gr duhet të jetë 30 gr ne disa 45 gr. Gjate hulumtimit që kemi bërë në treg nuk kemi hasur ëmbëlsira me peshe 30gr, por ka vetëm 45 gr ose 60-65gr. Prandaj është mire që këtë ta specifikoni ma saktësisht.

Ragip Mustafa,drejtor i SH.P.K “Beni Dona Plast”

Nr.Personal :1000661151

Vendbamimi, Prishtinë

Rr. "IMZOT NIK PRELAJ, ULPIANE

Përgjigjja juaj dt. 29.07.2019:

Të nderuar,

Më poshtë keni informatat sqaruese për projektin "FURNIZIM ME USHQIM PER PK-në — RI-TENDER" me nr. të prokurimit 214/19/043/111.

Pyetja 1:

Një OE ka kërkuar ndryshimin e kërkesave tek kapacitet ekonomike dhe financiare dhe tek kapacitet teknike dhe profesionale duke na sugjeruar ndryshim të kriterëve që do të zvogëlonin konkurrencën?

Përgjigjja 1:

Të gjitha kriteret ekonomike dhe financiare po ashtu edhe tek kriteret teknike dhe profesionale do të mbesin ashtu siç janë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë pas asnjë ndryshim.

Pyetja 2:

Sa i përket 1, 3, 7, 10 dhe 12 ekzistojnë nga dy variante. Kur është në pyetje pakot te cilat janë te specifikuar nga dy produkte tek te gjitha këto pako-racione që i përmenden dhe çmimi është i ndryshëm behet pyetja se si do të bëni porosinë e vetëm sipas pakos apo do të bëni ndarjen e produkteve te cilat gjinden brenda ne pako?

Përgjigjja 2:

Përgjigjeje nga komisioni për hartim te specifikave teknike:

. Sa i parkete pakove :1,3,7,10 dhe 12 janë te parapara nda dy mundësi për zgjedhje policia e përzgjedh njërin nga pakot brenda pakos se cilin opsion e donë sa i përket çmimit ato janë te përafërta andaj ne e cekur si mesatarë nuk e kemi pa te arsyeshme te shtohet numri i pakove.

Pyetja 3:

Pjesa e tortës ne disa prej pakove — racioneve është specifikuar se gr duhet te jete 30 gr ne disa 45 gr. Gjatë hulumtimit që kemi bërë në treg nuk kemi hasur ne ëmbëlsira me peshë 30g, por ka vetëm 45 gr ose 60-65 gr, prandaj është mirë që te ketë ta specifikoni ma saktësisht?

Përgjigjja 3:

Përgjigjeje nga komisioni për hartim te specifikave teknike : . Sa i përket ëmbëlsirave ato ne treg ekzistojnë torte 45 gr dhe ajo me 30gr Ëmbëlsire antiogsiduese.

Sipas hulumtimeve të cilat i kemi bërë në bashkëpunim me ekspertet e Gastronomisë dhe njohësit e tregut kemi ardhur në përfundim se atë të cilën ju mesë tepërmi e keni cekur për sasinë e shprehur në gr të llojeve të ndryshme të ushqimeve p.sh. patate, oriz, llazanje, makarona boloneze ose me dajth, vezë etj. ato nuk mundet të përmbajnë gr, por ato shërbehen me porcione për person, ku pjata mbushet në sasi të mjaftueshme për tu ngopur klienti i cili shërbehet me te gjegjësisht mund të shërbehet sa të ketë nevojë përpos mishit.

Ndërsa sa i përket lëngut të pemëve në tetrapak 500 ml, i cili kërkohet gati në të gjitha pakot të specifikuar në dosjen e tenderit për të cilin thoni se nuk gjendet në treg, ky lëng mund të shërbehet me dy copë në paketim nga 250 ml që do të jetë një shërbim shumë me 1 mirë dhe më i pëlqyer për konsumatorë të cilin njërën paketim mund ta konsumoi menjëherë ndërsa tjetrin të lënë sipas nevojës për me vonë .

Atë që e cekni se piruni, thika dhe luga e plastikës që ju thoni se janë të panevojshme ne konsiderojmë se këto të cilat i cekëm me lartë janë gjithsesi të nevojshme kur janë në pyetje shërbimet e ushqimeve në paketime alofoli dhe në shërbimet e ushqimeve të thata si p.sh. gullash, pasul, patate, peshk sardina, rriskë gjedhi, pashtetë pile etj....

Po i numërojmë disa prej pakove të cilat ju i keni theksuar në Raportin e Vlerësimit të Tenderëve të përgatitur

më 30/08/2019 se nuk janë të specifikuara mirë:

Pako 6 - ku ju potenconi se mishi i vicit me perime nuk është specifikuar perimet e përziera me të paktën 3 përbërje dhe sasia e perimeve në shujtë një ekspert gastronomie i cili merret me këtë është i obliguar të dije se kur është në pyetje përgatitja e këtij porcioni se sa është përbërja e perimeve të cilat duhet të përgatiten për këtë racion - pako 6, po ashtu në pakon nr 9 dhe në shumë pako tjera të cilat nuk po i cekim një nga një keni thënë që thika, piruni dhe lugët plastike nuk nevojiten, ndërsa ju kërkon që këto pako të shërbehen në alofoli. **Ju lutemi me çka do ta konsumojnë të shërbehen me këtë ushqim nëse nuk nevojiten sipas jush luga, thika dhe piruni i plastikës?**

Sa i përket lëngut të pemëve paketim tetrapak 500 ml të cilin autoriteti kontraktues Policia e Kosovës gati në të gjitha katërmëdhjetë (14) pakot të cilat janë pjesë e specifikimeve teknike të kësaj dosjeje të tenderit thotë se nuk gjendet në treg ju. informojmë 'se-ky konstatim i tyre nuk qëndron.

Sepse paketim në tetrapak të lëngjeve 500 ml 'ka në treg në sasi të. mjaftueshme.

Për informimin tuaj ky aktivitet i prokurimit është publikuar dy herë gjatë këtij viti:

Publikimi i parë ka ndodhur më 05/07/2019, ndërsa është anuluar më 12/07/2019 para hapjes me një arsyetim krejt të pakuptimtë: "Ndërprerja e aktivitetit prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe /apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit"

Provë: Njoftimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit datë 12/07/2019

Me datë 30/09/2019 e kanë anuluar për të dytën herë po ashtu me një arsyetim gati të njëjte vetëm tash anulimi bëhet pas hapjes së ofertave. "Një shkelje e LPP-së ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit"

Provë: B58 — Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues — anulim datë 30/08/2019

Në të dy rastet e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit shihet së në asnjërin rast nuk kanë pasur ndonjë arsye të argumentuar me fakte pse është anuluar. Arsyet i dinë vetëm përgjegjësit e autoritetit kontraktues Policia e Kosovës në krye me Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit.

Më 02/09/2019 autoritetit kontraktues Policia e Kosovës, përkatësisht Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit i kemi dërguar një kërkesë përmes e-prokurimit për sqarime shtesë lidhur me vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Përgjigja: "Ju njoftojë se aktivitetit i prokurimit është anuluar konform LLP-së, përkatësisht nenit 62 ku thuhet "një Një shkelje e LPP-së ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit"

Provë: E-mail i datë 02/09/2019

Në raportin e vlerësimit të tenderëve të datës 30/08/2019 janë munduar që japin një sqarim pak më të gjerë për anulim, por edhe ai sqarim nuk përmban ndonjë bazë të arsyeshme për anulim.

Provë Raporti i Vlerësimit të Tenderëve datë 30/08/2019

Në raportin e vlerësimit të tenderëve të datës 21/11/2019 ashtu si në raportin e vlerësimit të ofertave të datës 30/08/2019 asgjë nuk kanë shtuar më tepër, por janë munduar të japin një sqarim pak më të gjerë për anulim, por edhe ai sqarim nuk përmban ndonjë bazë të arsyeshme për anulim.

Provë Raporti i Vlerësimit të Tenderëve datë 21/11/2019

Sa i përket asaj që autoriteti kontraktues-Policia e Kosovës e ka cekur në Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues- anulim të datës 21/11/2019 si dhe Raportin e Vlerësimit të ofertave të njëjtës datë se gjoja nuk ka në tregun vendor lëng tetrapak të pemëve në paketim me peshë 0.5L ne ju vërtetojmë të kundërtën se lëngu i kërkuar gjendet në tregun tonë në sasi të mjaftueshme dhe sipas porosisë mund të furnizohen lloje të ndryshme të lëngjeve në këtë vëllim paketimi 0.5L.

Gjithashtu në bisedat që i kemi pas me ca kompani vendore të cilat merren me prodhimin e lëngjeve të pemëve në tetra-ak edhe pse tash për tash nuk e kanë në programin e tyre prodhues sipas nevojës dhe porosisë mund të prodhohet në çdo moment.

Kësaj Ankese do t'ia bashkëngjisim kopjen e skanuar të formës së paketimit të lëngut të pemëve në tetrapak 0.5L prodhim i një kompanie Kroate nga Zagrebi.

Autoriteti kontraktues Policia e Kosovës nuk ka respektuar Vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së me numër të protokollit 604/19 të datës 23/10/2019 në të cilin vendim thuhet citojmë:

- I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Beni Dona Plast" SH.P.K., Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me ushqim për PK-ën" – Ri-tender me numër të prokurimit: 70010-19-5052-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Policia e Kosovës.
- II. **ANULOHET** vendimi për anulim të aktivitetit të prokurimit "Furnizim me ushqim për PK-ën" – Ri-tender me numër të prokurimit: 70010-19-5052-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Policia e Kosovës, Dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.
- III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Po të pajtohej Paneli Shqyrtues i OSHP-së me Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues-anulim i datës **30/08/2019 me siguri nuk do të binte vendimin me numër protokollit 604/19 të datës 23/10/2019** i cili vendim aktivitetin e prokurimit me titull të lartë cekur e kthen në ri-vlerësim.

Mandej ju në cilësinë e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit të autoritetit kontraktues Policia e Kosovës në vend se ti përmbaheni pikës III të vendimit me numër të protokollit 604/19 të datës 23/10/2019 bëni një shkelje tjetër të radhës dhe nxirrni një vendim jo pas (10) ditëve, **por pas njëzet e tetë (28) ditëve**, vetëm me qëllim që të zgjatet sa më shumë afati i realizimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Prandaj duke konsideruar se me vendimet e ankimuar AK, ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave ligjore të lartshënuara të LPP-se dhe akteve tjera nënligjore që si pasojë nga shkeljet e pretenduara ka rezultuar me dëmtimin e Operatorit Ekonomik "Beni Dona Plast" Ulpiana Tregu i Gjellbërit Prishtinë kërkojmë nga AK Departamenti i prokurimit Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të formojë një komision për trajtimin e Kërkesës tonë për Rishqyrtim për aktivitetin e lartëcekur të prokurimit dhe pas shqyrtimit dhe marrjes në konsideratë si dhe duke iu dhënë peshë të gjitha fakteve të paraqitura në ankesë-kërkesë për Rishqyrtim dhe pas veprimeve korrigjuese, i propozojmë të merr këtë:

V E N D I M

- Miratohet si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik "Beni Dona Plast" Ulpiana Tregu i Gjellbërit Prishtinë.
- Anulohet Vendimi, përkatësisht Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit i publikuar në ueb faqen e platformës elektronike të KRPP-së me datë 21 /11/2019.
- Të mirren masa adekuate korrigjuese për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendosen që me

kontratë publike për aktivitetin e lartë cekur të prokurimit të shpërblehet oferta e Operatorit Ekonomik Beni Dona Plast" Ulpiana Tregu i Gjellbërit Prishtinë si ofertues i vetëm i përgjegjshëm me çmimin më të ulët që plotëson të gjitha kriteret e specifikuar në Njoftimin për Kontratë dhe në dokumentet të cilat përbëjnë dosjen e tenderit.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, janë të njëjta me ato të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore).

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Specifikat për ushqimin e Zyrtarëve policor sipas Pakove

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit dhe vlerësimit jep rekomandim që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në tërësi pas identifikimit të gabimeve në specifika teknike

Konform Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Neni 62 Përfundimi i aktivitetit të Prokurimit, Pika 1. Autoriteti Kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të Prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dënimin e kontratës vetëm për njërin nga arsyet :

1.1 Një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit; duke përfshirë edhe rastet kur je dispozite e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Konform rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurim publik, 44 Nderprerja e e procedurave të prokurimit pika 44.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

Një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo parandalohet përmes një ndryshimi.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

Tenderuesi ankues, "Beni Dona Plast" sh.p.k., Prishtinë është palë me interes sipas nenit 4.1.26 nga rezultati i këtij aktivitetit të prokurimit të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, në raport me këtë kontratë që mund të jetë në rrezik të dëmtimit material nga një shkelje e pretenduar.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

Vendimi i Panelit Shqyrtues me numër 604/19, i datës 23.10.2019

PANELI SHQYRTUES, i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të LPP-së, ka vendosur, sipas ankesës të parashtruar nga Tenderuesi ankues, "Beni Dona Plast" sh.p.k., Prishtinë,

kundër vendimit të AK-së – për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me ushqim për PK-ën – Ri-Tender, me nr. të prokurimit: 214-19-5204-1-1-1 dhe Numri i brendshëm: 214/19/043/111, i iniciuar nga AK- Policia e Kosovës, më datën 23.10.2019, ka pruar:

VENDIM

I. **APROVOHET** si e bazuara ankesa e operatorit ekonomik "Beni Dona Plast" sh.p.k., Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Furnizim me ushqim për PK-ën – Ri-Tender, me nr. të prokurimit: 214-19-5204-1-1-1 dhe Numri i brendshëm: 214/19/043/111, i iniciuar nga AK- Policia e Kosovës.

II. **ANULOHET**, vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit njoftimi, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: Furnizim me ushqim për PK-ën – Ri-Tender, me nr. të prokurimit: 214-19-5204-1-1-1 dhe Numri i brendshëm: 214/19/043/111, i iniciuar nga AK- Policia e Kosovës dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me aktivitetin e prokurimit me titullin e lartë cekur e kthen në rivlerësim.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Tenderuesi Ankues, "Beni Dona Plast" sh.p.k., Prishtinë, deklaroi se Nuk pajtohet me Njoftimin mbi vendimin e publikuar nga AK- POLICIA E KOSOVËS të datë 25.11.2019, me pretendimin "se aktiviteti i prokurimit është anuluar konform LPP-së, përkatësisht nenit 62 të LPP ku thuhet "një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit" dhe PRETENDON se AK ka bërë gabim gjatë vlerësimit të tenderit.

Dispozitat e shkelura të LPP-së, sipas tenderuesit ankues, nga ana e Autoriteti Kontraktues, janë:

Neni 1, i LPP-së, *Qëllimi*

Neni 2, i LPP-së, *Fushëveprimi*

Neni 6, i LPP-së, *Ekonomiciteti dhe Efikasiteti*

Neni 59, i LPP-së, *Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve*

Neni 40 i RRUOPP-së (*Krijimi i Komisioneve Vlerësuese të tenderëve*)

Neni 41 i RRUOPP-së (*Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve*)

Neni 62 i LPP-së, *Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit,*

Neni 44.5 i RRUOPP (*Ndërprerja e procedurave të prokurimit,*)

Neni 105 i LPP-së, (*Kompetencat e OSHP-së*)

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar në shkresat e lëndës së trajtuar sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 1 i LPP - Qëllimi)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, se është shkelur Neni 1 i LPP-së (Qëllimi) është i bazuar, sepse me rastin e shqyrtimit të lëndës për këtë aktivitet të prokurimit, gjatë procesit të vlerësimit Autoriteti Kontraktues me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit për herë të dytë, duke mos e zbatuar vendimin e OSHP-së, PSH-së nr. 604/19, të datës: 23.10.2019 të cilin aktivitet të prokurimit e ka tenderuar DY herë, Autoriteti kontraktues nuk e ka arritur Qëllimin e paraparë në këtë aktivitet të prokurimit, si është paraparë në nenin 1 të LPP –së, citojmë :

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen,

procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.
3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellin duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërsaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 2 i LPP - Fushëveprimi).

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, se është shkelur Neni 2 i LPP-së (*Fushëveprimi*) është i bazuar, sepse me rastin e shqyrtimit të lëndës për këtë aktivitet të prokurimit, gjatë procesit të vlerësimit Autoriteti Kontraktues me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, duke mos e zbatuar vendimin e OSHP-së, PSH-së nr. 604/19, të datës: 23.10.2019, Autoriteti kontraktues nuk i ka zbatuar, përmbajtur dhe respektuar kërkesat procedurale dhe përmbajtëse të këtij ligji si është paraparë në nenin 2 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 6 i LPP - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti).

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, se është shkelur Neni 6 i LPP-së (*Ekonomiciteti dhe Efikasiteti*) është i bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues me vendimin e marrë për herë të dytë për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, duke e tenderuar DY herë, nuk e ka arritur që me veprimet e veta të veproj në pajtueshmëri me Nenin 6 të LPP-së, sepse citojmë :

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 59) Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i bazuar, sepse duke u bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues me vendimin e marrë për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit edhe për herë të dytë, nuk ka vepruar në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj:

“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Prandaj, në bazë të analizës së dokumentacionit të prezantuar, pretendimet e Tenderuesin Ankues, Beni Dona Plast SH.P.K., Prishtinë, janë të qëndrueshme, sepse tenderuesi ankues ka dorëzuar tender

të përgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues, me rastin e kontrollimit të dokumentacionin të dorëzuar për këtë tender, konstaton se Autoriteti Kontraktues, duke u thirrur kinse, citojmë:

- *aktiviteti i prokurimit është anuluar konform LPP-ës, përkatësisht nenit 62 të LPP ku thuhet "një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit".*

ka bërë shkelje të dispozitave ligjore duke e anuluar aktivitetin e prokurimit, ky vendi i marrë dhe këto konstatime nuk qëndrojnë, sepse, janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme gjatë kohës së tenderimit, janë kërkuar sqarime shtesë dhe janë marrë përgjigje përkatëse nga na e Autoritetit kontraktues për të gjithë Operatorët Ekonomik pjesëmarrës me datë 29.07.2019.

Nga rrjedha e kësaj procedure, shihet se aktiviteti i prokurimit për këtë tender herën e parë është publikuar më 05.07.2019, ndërsa është anuluar para hapjes së ofertave me 15.07.2019 me të njëjtin arsyetim

- ☒ Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit

Autoriteti kontraktues e ka ri tenderuar aktivitetin e prokurimit, FURNIZIM ME USHQIM PËR PK-ËN – RI-TENDER me 25.07.2019.

Gjatë kohës së tenderimit, nga tenderuesi ankues Beni Dona Plast SH.P.K., Prishtinë, është dorëzuar kërkesë për sqarime shtesë të tenderit përmes platformës elektronike të prokurimit me datë 26.07.2019, në të cilën janë përfshirë një numër i madh i paqartësive të cilat i ka identifikuar ankuesi.

Eksperti shqyrtues, konstaton se nga pyetjet e bëra nga OE ankues dhe përgjigjet e marra nga Autoriteti Kontraktues, janë qartësuar dilemat dhe paqartësitë, janë sqaruar pakot ushqimore, dhe nuk ka pasur tjetër kërkesë për sqarime, gjatë kohës së tenderimit nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës. Andaj të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues duke pasur përgjegjësi të plotë individuale, është dashtë ta kryejnë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave-tenderëve, në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Duke u mbështetur në këto argumente të cekuara më lartë, të cilat janë shtjelluar në mënyrë detale nga eksperti në raportin për ankesën me numër 604/19 të datës 25.09.2019, në bazë të cilave rekomandime PANELI SHQYRTUES, i OSHP-së, ka marrë Vendim, ANULOHEM vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: Furnizim me ushqim për PK-ën – Ri-Tender, me nr. të prokurimit: 214-19-5204-1-1-1 dhe Numri i brendshëm: 214/19/043/111, i iniciuar nga AK- Policia e Kosovës dhe lënden e ka kthyer në Ri-vlerësim.

Mirëpo, Autoriteti Kontraktues e ka bërë Ekzaminimin, vlerësimin e Tenderit, duke mos e respektuar vendimin e OSHP-së, PSH-së nr. 604/19, të datës: 25.09.2019.

Në arsyetimin e anulimit të Tenderuesi ankues, ("Beni Dona Plast" sh.p.k, Prishtinë), gjatë rivlerësimit AK i ka përsëritur arsyet e njëjta për anulimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj nga kjo që u cekë më lartë është plotësuar kërkesat ligjore që çështja në fjale të

kualifikohet "Res Judicata", andaj sipas Nenit 105 paragrafi 2 pika 16 i cilëson Res Judicata "Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata".

Pas këtyre argumenteve të prezantuara më lartë, eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues me rastin e marrjes së Vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit për herë të dytë ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, dhe Neni 41 i RRUOPP.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 62, Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit) dhe Neni 44.5 i RRUOPP (Ndërprerja e procedurave të prokurimit)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, se nuk është respektuar dhe zbatuar si duhet Nenin 62 të LPP-së dhe Neni 44.5 i RRUOPP me rastin e vlerësimit të tenderëve, është i pabazuar, sepse nuk është respektuar ky nen (44.5) ku kërkohet (citojmë):

44.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

- (i) asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- (ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
- (iii) numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE - është më pak se 3;
- (iv) nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- (v) numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
- (vi) nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
- (vii) asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
- (viii) nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
- (ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
- (x) nëse AK gjate përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-së është i pariparueshëm; ose
- (xi) nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.:

Duke u bazuar në fakte të prezantuara në dokumentacionin që kam shqyrtuar, analizuar dhe krahasuar dhe në atë që u tha më lartë në këtë raport, Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Nenin 62 të LPP-së dhe Neni 44.5 i RRUOPP, sepse pa arsye e ka anuluar -Përfundua Aktivitetin e Prokurimit, sepse nuk ka ndodhur asnjë shkelje e ligjit ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet

apo të parandalohet përmes një ndryshimi, për këtë aktivitet të prokurimit.

Kjo është konstatuar nga Eksperti shqyrtues herën e kaluar dhe është vërtetuar dhe gjykuar nga Paneli Shqyrtues, me vendimin 604/19 të datës 25.09.2019.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 105 i LPP-së, (Kompetencat e OSHP-së):

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, se është shkelur dhe nuk është zbatuar si duhet Neni 105 të LPP-së me rastin e rivlerësimit të tenderëve nga AK (Kompetencat e OSHP-së) nuk është i bazuar, sepse tani janë pjekë kushtet që OSHP-ja ti përdor kompetencat e veta, në pajtueshmëri me *Nenin 105 paragrafi 2 pika 10*, meqenëse janë përsëritura pretendimet e njëjta ankimore, pasi objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta dhe janë shqyrtuar më parë nga ky organ me vendimin PSH-së nr. 604/19, të datës: 23.10.2019.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues, që në pajtueshmëri me nenin 105 të *Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092*, ti dërgojë URDHËRESE Autoriteti Kontraktues — POLICIA E KOSOVËS me të cilën duhet:

- APROVOHET, si e bazuar ankesa e tenderuesit “Beni Dona Plast” sh.p.k., Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: FURNIZIM ME USHQIM PËR PK-ËN – RI-TENDER, me nr. të prokurimit: 214-19-5204-1-1-1 dhe Numri i brendshëm: 214/19/043/111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues — POLICIA E KOSOVËS.
- OBLIGOHET, autoriteti kontraktues, POLICIA E KOSOVËS që të zbatojë vendimin PSH-së nr. 604/19, të datës: 23.10.2019 për aktivitetin e prokurimit me titull: FURNIZIM ME USHQIM PËR PK-ËN – RI-TENDER, me nr. të prokurimit: 214-19-5204-1-1-1 dhe Numri i brendshëm: 214/19/043/111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues — POLICIA E KOSOVËS.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- | | |
|---------------------------|-----------------------------------------|
| - Autoritetit Kontraktues | - POLICIA E KOSOVËS. |
| - Panelit Shqyrtues | - OSHP. |
| - OE ankues : | - “Beni Dona Plast” sh.p.k., Prishtinë, |